



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2494/4 prot

Datë 31/10/2023

**V E N D I M**  
**Nr. 1103/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31/10/2023 me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-82854-10-09-2023, me objekt “Sherbim Mirembajtje e Programit te Faturimit Flare Billing per 12 muaj” me fond limit 6.000.000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster SH.A.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-82854-10-09-2023, me objekt “Sherbim Mirembajtje e Programit te Faturimit Flare Billing per 12 muaj” me fond limit 6.000.000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster SH.A.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK, me NIPT:  
L42202028V  
Adresa: Rruga “Margarita Tutulani”, Pallati Viridario 1,  
Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster SH.A  
*Adresa: Gjirokastër*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.10.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Proçedurë e Hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-82854-10-09-2023, me objekt

“*Sherbim Mirembajtje e Programit te Faturimit Flare Billing per 12 muaj*” me fond limit 6.000.000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster SH.A.

II.2. Në datën 12.10.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3490 dhe me nr. 2494 prot., datë 12.10.2023 e operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesat e plota të ankimuesve.

II.4. Me shkresën nr. 3900 prot., datë 18.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2494/3 prot., datë 23.10.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues “Primus Albania” SHPK.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr. 3900 prot., datë 18.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2494/3 prot., datë 23.10.2023 rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK ku ka vendosur që të pranojë pjesërisht pretendimet e ankimuesit, si më poshtë vijon:

“[...].... 1. Argumentimi i AK për pikën I të ankesës:

*Referuar ankesës së paraqitur AK për shkak të një lapsusi nuk ka zgjedhur anjë nga format për sigurimin e ofertës duke lënë të hapur mundësinë e zgjedhjes nga OE të një nga dy pikat, garancie bankare apo nga një shoqëri sigurimi e licensuar.*

*Gjithashtu është parashikuar në pikën 3.1 “sigurimi i ofertës” ku është shprehur në fjalë por jo në përqindje vlera që OE duhet të dorëzojë në SPE duke e vlerësuar si të ezauruar si informacin por për të qënë sa më transparent edhe shterues në DST;*

*AK do të bëjë ndryshimet e nevojshme me anë të shtojcës përkatëse duke specifikuar sa cituam më lart pretendimet e OE Primus.*

2. Argumentimi i AK për pikën II të ankesës:

*Referuar pretendimit të operatorit Primus Albania, mendojmë që është qartësisht e dukshme që vendi i ekzekutnimit të kontratës do të jetë Shoqeria Rajonale Ujsjelles Kanalizime Gjirokastër Sh.a e përcaktuar kjo te 2.12 e DST-së.*

3. Argumentimi i AK për pikën III të ankesës:

*AK në hartimin e këtij kriteri ka patur parasysht faktin që certifikatat ISO të jenë të përditësuar duke ju referuar specifikisht që ato të jenë aktive dhe të rregullta sipas legjislacionit në fuqi.*

*Duke ju referuar dhe vendimit të KPP që ju keni cituar pretendimi i OE Primus Albania qendron dhe AK do të bëjë ndryshimet e nevojshme me anë të shtojcës përkatëse.[...]”.*

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës nr. 3900 prot., datë 18.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2494/3 prot., datë 23.10.2023, rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës duke cituar se:

*“[...].... 1. Argumentimi i AK për pikën I të ankesës:*

*Referuar ankesës së paraqitur AK për shkak të një lapsusi nuk ka zgjedhur anjë nga format për sigurimin e ofertës duke lënë të hapur mundësinë e zgjedhjes nga OE të një nga dy pikat, garancie bankare apo nga një shoqëri sigurimi e licensuar.*

*Gjithashtu është parashikuar në pikën 3.1 “sigurimi i ofertës” ku është shprehur në fjalë por jo në përqindje vlera që OE duhet të dorëzojë në SPE duke e vlerësuar si të ezauruar si informacin por për të qënë sa më transparent edhe shterues në DST;*

*AK do të bëjë ndryshimet e nevojshme me anë të shtojcës përkatëse duke specifikuar sa cituam më lart pretendimet e OE Primus.*

*2. Argumentimi i AK për pikën II të ankesës:*

*Referuar pretendimit të operatorit Primus Albania, mendojmë që është qartësisht e dukshme që vendi i ekzekutnimit të kontratës do të jetë Shoqëria Rajonale Ujshjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a e përcaktuar kjo te 2.12 e DST-së.*

*3. Argumentimi i AK për pikën III të ankesës:*

*AK në hartimin e këtij kriteri ka patur parasysh faktin që çertifikatat ISO të jenë të përditësuar duke ju referuar specifikisht që ato të jenë aktive dhe të rregullta sipas legjislacionit në fuqi.*

*Duke ju referuar dhe vendimit të KPP që ju keni cituar pretendimi i OE Primus Albania qendron dhe AK do të bëjë ndryshimet e nevojshme me anë të shtojcës përkatëse. [...]”.*

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 2494 protokollit me datë 12.10.2023 dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3490 e operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK për modifikimin e kriterit 2.3.3 të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “... Në këtë kriter, në Shtojcën 5 Formulari i Specifikimeve Teknike, por edhe në asnjë fjali të DST nuk është dhënë si informacion teknologjia/gjuha e programimit e përdorur për të krijuar/implementuar programin që autoriteti kontraktor ka aktualisht në përdorim. Në këto kushte kushdo operator ekonomik (përveç autorit të programit) e ka të pamundur për mungesë informacioni të propozojë punonjësit e çertifikuar “në zhvillim dhe implementim e zgjidhjes që AK ka në përdorim”, pasi mungon informacioni bazë, kush është teknologjia/gjuha e programimit e përdorur për të krijuar/ implementuar programin.

...

Pra, në argumentim ju citoni se punonjësi duhet të jetë i çertifikuar në zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjes që shoqëria ka në përdorim “Flare Billing”, duke ju referuar një produkti të gatshëm por edhe këtu pa saktësuar se kush është teknologjia/gjuha e programimit e përdorur për krijimin/implementimin e programit. Lenia evasive dhe e papërcaktuar e teknologjisë/gjuhës të programimit të përdorur për të krijuar/ implementuar programin do të thotë mungesë e plotë informacioni dhe paqartësi, informacion, që do të krijonte mundësi dhe hapësira operatorëve ekonomikë në përmbushjen e këtij kriteri. Kjo është në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 77 Kërkesat për Kualifikim, pika 5, citojmë si më poshtë: 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e

kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve. Në rastin konkret ju keni përcaktuar kriterin e përzgjedhjes, por nuk keni përdokumentin/et konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr. 8, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

**“3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë te punesuar te pakten 4 punonjes te diplomuar ne fushen e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj). Plotesimi i ketij kriteri duhet te vertetohet me paraqitjen e formulareve E-SIG per periudhen e 3 muajve te fundit duke iu referuar dates se hapjes se ofertave dhe diplomave te shkollimit te larte universitar per secilin prej punonjesve. Keta punonjes duhet te jene te certifikuar si vijon:**

- a. Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar si “Ekspert te Certifikuar” ne zhvillim dhe implementim e zgjidhjes qe AK ka ne perdorim.  
- Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatese per punonjesit
- b. Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1 specialist te certifikuar ne konceptet, inxhinierizimin e Web sherbimeve dhe protokollit SOAP. Keto certifikata garantojne qe programuesit jane te aftesuar ne zhvillimin e sistemeve me arkitekture te prirur drejt sherbimeve ne rrjet/sistemeve te shperndara.  
-Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatesen per punonjesin.
- c. Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).  
- Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatese per punonjesin.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.”**

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.  
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.  
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.2.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.2.4. Në nenin 77, pikat 1, 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se::

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.2.5. Në nenin 41, pikat 2, 4 dhe 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me afësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

*4. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

*d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

*6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*

III.2.5. Referuar procesverbalit “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në Sistemin Elektronik të Prokurimit konstatohet se është përcaktuar, si më poshtë:

***“2.3.3. Per te vertetuar qe ka kapacitete njerezore, profesionale te mjaftueshme per realizimin ne kohe dhe sipas specifikimeve teknike te projektit, operatori ekonomik duhet te kete te punesuar te pakten 4 punonjes te diplomuar ne fushen e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj). Plotesimi i ketij kriteri duhet te vertetohet me paraqitjen e formulareve E-SIG per periudhen e 3 muajve te fundit duke iu referuar dates se hapjes se ofertave dhe diplomave te shkollimit te larte universitar per secilin prej punonjesve.***

***Argumentimi:*** Kjo kerkese vendoset ne mbeshtetje te nenit 77 pika 1 e Ligjit Nr. 162 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, ku parashikohet se:

*Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatoret ekonomike bazuar ne:*

*a) pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftesine teknike dhe profesionale.*

*Per realizimin e ketij sherbimi kerkohet qe ne secilen nga fushat kryesore te projektit, operatori ekonomik te perdori personel teknik te mjaftueshem dhe te kualifikuar. Fushat e mesiperme te ekspertizes si dhe numri i personelit te certifikuar, jane kryer ne baze te komponenteve te projektit si dhe te mases se angazhimit te specialisteve. Diplomimi i punonjesve ne degët*



*Informatike ose Teknologji-Informacioni ose Elektronike, eshte kerkuar ne perputhje me objektin e prokurimit dhe termat e references pasi ky objekt prokurimi perfshine implementimin, adaptimin, testimin, migrim dhe instalimin e te gjitha informacioneve teknike te sistemit si dhe duhet te ofroje trajnim per perdoruesit.*

***a.Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar si “Ekspert te Certifikuar” ne zhvillim dhe implementim e zgjidhjes se faturimit qe AK ka ne perdorim.***

***- Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatese per punonjesit***

***Argumentim:*** *Qe te sigurohet nje mirembatje sa me eficente e Programit te Faturimit qe shoqeria ka ne perdorim, zgjidhja ne kohe e problemeve, etj, kerkohet qe Operatori Ekonomik te kete te punesuar te pakten 2 punonjes te certifikuar nga prodhuesi i teknologjive baze te sistemit. Punonjesi i certifikuar ne zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjes qe shoqeria ka ne perdorim “Flare Billing” ben te mundur qe zgjidhjet e probleme te behen brenda afateve te percaktuar ne SLA dhe ne kete menyre te mos krijohet asnje problematike ne sistemin e faturimit. Ne kete menyre AK ka garancine qe te njihet mire sistemi aktual i faturimit dhe tmos krijohet asnje problematike qe mund te sjelle nderprerje te proceseve te rendesishme te faturimit dhe ne kete menyre te AK te arketoje pagesat e kryera. Ekspertet e certifikuar bejne te mundur qe realizimi i kontrates dhe specifikimeve te saj te jete sa me i plote,shterues dhe ne afatet e percaktuara duke beret e mundur mbarvajtjen normale te procesit te punes.”.*

III.2.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, duke modifikuar kriteret për disponimin e te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar si “Ekspert te Certifikuar” ne zhvillim dhe implementim e zgjidhjes qe AK ka ne perdorim, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret, që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë, se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i termave të referencës/specifikimet teknike, Komisioni gjykon se bazuar në kompleksitetin, volumin dhe elementet konkrete të kontratës objekt-prokurimi, kërkesat për disponimin e punonjësve të certifikuar në kategoritë e kualifikimeve të mësipërme nuk janë të ekzagjeruara dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj kontrate, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të sigurohet, që operatorët ekonomikë ofertues disponojnë stafin me aftësitë dhe ekspertizat e duhura për të zbatuar me sukses kontratën objekt-prokurimi. Por, përcaktimi i certifikatave të lëshuara nga kompani të posaçme, gjuhë programimi dhe për kualifikime mbi produkte të prodhuara nga këto të fundit, kufizon

në mënyrë të panevojshme konkurrencën dhe gamën e zgjidhjeve të propozuara, si dhe bie në kundërshtim edhe me vetë përcaktimet e autoritetit kontraktor në specifikimet teknike, ku evidentohet se zgjidhja është lënë në diskrecion të operatorëve ekonomikë. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë kriteret e mësipërme duke mos e përcaktuar titullin e certifikatave apo subjektin lëshues të saj, që nevojiten për të vërtetuar aftësitë e punonjësve, por të përcaktojnë certifikatat bazuar në funksionin dhe nivelin e ekspertizës që duhet të zotërojnë këta punonjës, me anë të termave funksionale.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK për modifikimin e kriterit 2.3.3 të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “... Referuar kriterit dhe argumentimit të tij del e qartë që është kërkuar 1 (një) specialist që të jetë i certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e Ëeb dhe në protokollin SOAP. Së pari, kërkesa që një specialist të ketë më shumë se një certifikatë kufizon në mënyrë të padrejtë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit, çënon parimet bazë të ligjit të prokurimit publik dhe konkretisht: i) redukton pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ii) redukton konkurrencën ndërmjet operatorëve; iii) nuk siguron një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Së dyti, referuar kriterit dhe konkretisht “Operatori ekonomik duhet të ketë te pakten 1 specialist të certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e Ëeb shërbimeve?”, Shtojcës 5 Specifikimeve Teknike, dhe bazuar në kompleksitetin, volumin dhe elementet konkrete të kontratës objekt-prokurimi, kriteri për disponimin e 1 (një) punonjësi të certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e Ëeb shërbimeve është i ekzagjeruar dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj kontrate. Në Specifikimet Teknike të shërbimit të kërkuar nuk del askund nevoja e AK për shërbime Ëeb. Pra, ky kriter është jo në përputhje me detyrat që duhet të kryejë Kontraktori në përmbushje të kontratës referencë. Referuar sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri në përputhje me përcaktimet, kërkesat ligjore dhe natyrën e shërbimeve që kërkohen. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në Shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

**“Shtojca 5.**

*[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]*

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**Objekti:** “Mirembajtje e Programit të Faturimit Flare Billing për 12 muaj”.

*Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me*

përrjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

## **I. Hyrje**

Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster operon ne nje shtrirje gjeografike te konsiderueshme dhe ka ne administrimin e saj 7 njesi administrative dhe perkatesisht Gjirokaster, Tepelene, Memaliaj, Kelcyre, Permet, Libohove dhe Dropull. Shoqeria menaxhon te gjithë te dhenat e saj si dhe gjeneron faturat e abonenteve me ane te programit te Faturimit Flare Billing i cili operon ne Cloud. Ky program eshte i aksesueshem ne te gjithë arkat e njesive administrative te lertepemenduar si dhe ne zyrat e njesive. Numri i madh i operatorve si dhe numri akoma me i larte i transaksioneve eshte shume e nevojshme mirembajtja e ketij sistemi kaq deciziv per Shoqerine tone.

## **II. Objekti i shërbimit**

Objekti i shërbimit eshte mirembajtja programit te Faturimit Flare Billing.

## **III. Afati i shërbimit**

-Afati I shërbimit do te jete 12 muaj nga lidhja e kontrates.

**-Rezultatet qe duhet te arrihen.**

Mirembajtja e programit te Faturimit Flare Billing qe ka ne perdorim.

**Detyrat e Operatorit Ekonomik**

- Mirembajtje e programit te Faturimit gjate gjithë periudhes se percaktuar ne kontrate.
- Zgjidhje e problemeve teknike prej keqfunksionimit te softëare.
- Dorezim i raportit mujor te mirembajtjes.

## **IV. PËRGJIGJJA DHE SHKALLËZIMI I SHËRBIMIT**

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre.

**Kategoria A ( Kritik/ I Larte)**

**Kategoria B (I Mesem)**

**Kategoria C (I Ulet)**

<i>Mos funksionimi i programit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal</i>	<i>Mos funksionimi i programit krijon vonesa në aktivitetin normal</i>	<i>Mos funksionimi i programit pengon në mënyrë minimal aktivitetin</i>
<b>Numri i përdoruesve të ndikuar</b>		
<i>Mos funksionimi i programit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve</i>	<i>Mos funksionimi i programit ndikon një numër të vogël të përdoruesve</i>	<i>Mos funksionimi i programit ndikon pjesërisht në disa përdorues</i>
<b>Pezullimi i punës</b>		
<i>Mos funksionimi i programit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.</u></i>	<i>Mos funksionimi i programit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesë të punës së tyre</u></i>	<i>Mos funksionimi i programit pengon përdoruesit <u>të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre.</u></i>
<b>Zgjidhje alternative e përkohshme</b>		
<i><u>Nuk ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit</u></i>	<i><u>Ka pjesërisht një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.</u></i>	<i><u>Ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.</u></i>
<b>Koha e përgjigjes</b>		
<i>○ 30 min. për të kthyer përgjigje</i>	<i>○ 30 min. për të kthyer përgjigje</i>	<i>○ 30 min. për të kthyer përgjigje</i>
<b>Koha e zgjidhjes</b>		
<i>Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 24 orë pas kërkesës.</i>	<i>Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.</i>	<i>Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.</i>

III.3.2. Në shtojcën nr. 8, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon: “.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar te pakten 4 punonjes të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkencë kompjuterike etj). Plotesimi i këtij kriteri duhet të vërtetohet me paraqitjen e formulareve E-SIG për periudhën e 3 muajve të fundit duke iu referuar datës së hapjes së ofertave dhe diplomave të shkollimit të lartë universitar për secilin prej punonjesve. Keta punonjes duhet të jenë të certifikuar si vijon:

- a. Operatori ekonomik duhet të ketë te pakten 2 (dy) punonjes të certifikuar si “Ekspert të Certifikuar” në zhvillim dhe implementim të zgjidhjes që AK ka në përdorim.  
- Ky kriter të plotesohet me paraqitjen e certifikatës përkatëse për punonjesit

**b. Operatori ekonomik duhet te kete te pakten I specialist te certifikuar ne konceptet, inxhinierizimin e Eëb sherbimeve dhe protokollit SOAP. Keto certifikata garantojne qe programuesit jane te aftesuar ne zhvillimin e sistemeve me arkitekture te prirur drejt sherbimeve ne rrjet/sistemeve te shperndara.**

-Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatesen per punonjesin.

c. Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar pakten I (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).

- Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatese per punonjesin.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.”

III.3.3. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.3.4. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.3.5. Nga shqyrtimi i procesverbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim” të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në Sistemin e Prokurimit Elektronik konstatohet se autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri si më poshtë:

***“b.Operatori ekonomik duhet te kete te pakten I specialist te certifikuar ne konceptet, inxhinierizimin e Eëb sherbimeve dhe protokollit SOAP. Keto certifikata garantojne qe programuesit jane te aftesuar ne zhvillimin e sistemeve me arkitekture te prirur drejt sherbimeve ne rrjet/sistemeve te shperndara.***

**-Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatesen per punonjesin.**

**Argumentim:** *Specialisti i siperctuar nevojitet per te garantuar integrimin mes sistemeve te brendshme dhe me sistemet e paleve te treta. Keto certifikata garantojne qe programuesit jane te aftesuar ne zhvillimin e sistemeve me arkitekture te prirur drejt sherbimeve ne rrjet/sistemeve te shperndara”.*

III.3.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, duke modifikuar kriteret për disponimin e te pakten 1 specialist te certifikuar ne konceptet, inxhinierizimin e Ëeb sherbimeve dhe protokollit SOAP. Keto certifikata garantojne qe programuesit jane te aftesuar ne zhvillimin e sistemeve me arkitekture te prirur drejt sherbimeve ne rrjet/sistemeve te shperndara, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret, që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë, se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Por, përcaktimi i certifikatave të lëshuara nga kompani të posaçme, gjuhë programimi dhe për kualifikime mbi produkte të prodhuara nga këto të fundit, kufizon në mënyrë të panevojshme konkurrencën dhe gamën e zgjidhjeve të propozuara, si dhe bie në kundërshtim edhe me vetë përcaktimet e autoritetit kontraktor në specifikimet teknike, ku evidentohet se zgjidhja është lënë në diskrecion të operatorëve ekonomikë.

Për më tepër autoriteti kontraktor nuk ka pasqyruar në shtojcën 5 nevojën për “Ëeb shërbime”. Në kthim përgjigje të autoritetit kontraktor ka cituar se: “Në lidhje me pjesën ku thoni që “Në Specifikimet Teknike të shërbimit të kërkuar nuk del askund nevoja e AK për shërbime ËEB” ju bëjmë me dije që për shkak të një lapsusi mungon pika e caktuar”, duke pranuar që në specifikime teknike nuk është parashikuar ky shërbim, shtimi i specifikimeve teknike do të sillte edhe ndryshimin e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3, duke hequr pikën “b”.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

**III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK për modifikimin e kriterit 2.3.4 të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “... Pra, në kërkesën/kriterin tuaj për kualifikim 2.3.4 mungon togfjalëshi “ose ekuivalent” pas togfjalëshit “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributor i**

autorizuar i zgjidhjes FLARE BILLING qe eshte zgjidhja në përdorim”, ashtu siç kërkon ligji dhe vetë DST.

...

Duke u fokusuar vetëm tek objekti i prokurimit dhe jo të dhënat e tjera të asaj kontrate (si vlera, afati, etj.), bazuar në të dhënat e mësipërme rezulton që në vitin 2021, ish-Sh.A. Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër ka prokuruar dhe instaluar më pas programin kompjuterik të faturimit që aktualisht përdor sot dhe që kërkon po mirëmbajtjen e tij për Shoqërinë Rajonale të Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër sh.a. Me prokurimin (blerjen) dhe instalimin e atij programi kompjuterik faturimi ish-Sh.A. Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër ka fituar të drejtat mbi atë program përfshi dhe ndërhyrjen në të për përditësim, mirëmbajtje, etj., pa marrë paraprakisht autorizimin e prodhuesit. Për këtë qëllim krahas programit të instaluar në serverat e tij Kontraktori ka detyrimin të furnizojë AK edhe me Kodin Burim (source code) të programit. Kodi burim i programit mundëson hyrjen në të për zhvillime, përditësime dhe mirëmbajtjen e programit, mjafton profesionalizimi dhe çertifikimi i ekspertit që do ndërhyjë. Nëse pranojmë të kundërtën, pra autorizimin në çdo rast të prodhuesit/ autorit për të ndërhyrë/mirëmbajtur sistemin/programin, atëhere duhet të pranojmë faktin që mirëmbajtja e të gjitha programeve kompjuterike të krijuara do të kthehej në ekskluzivitet të prodhuesve të tyre, pra do të kishim një treg monopol për çdo program kompjuterik, praktikisht do të zhdukej konkurrenca dhe zhvillimi. Në dokumentet standarte të tenderit për kategorinë mallraë në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës LPP parashikon si më poshtë: 1.7 E drejta e autorit 1.7.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha vizatimet, dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve. Për paligjshmërinë e vendosjes të markës apo e termit “ekivalentë në kriterin e kualifikimit është shprehur edhe KPP me vendimin e tij nr. 386/2023, faqja 55 dhe 56. Referuar sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri në përputhje me përcaktimet, kërkesat ligjore dhe vendimin e KPP. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në Shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

**“Shtojca 5.**

*[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**Objekti:** “Mirembajtje e Programit te Faturimit Flare Billing per 12 muaj”.

*Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me*

*përrjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.*

*SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

*Skicimet, parametrat teknik etj:*

*Specifikimi i Materialeve:*

*Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:*

## **V. Hyrje**

*Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirrokaster operon në një shtrirje gjeografike të konsiderueshme dhe ka në administrimin e saj 7 njësi administrative dhe perkatesisht Gjirrokaster, Tepelene, Memaliaj, Kelcyre, Permet, Libohovë dhe Dropull. Shoqëria menaxhon të gjithë të dhënat e saj si dhe gjeneron faturat e abonenteve me anë të programit të Faturimit Flare Billing i cili operon në Cloud. Ky program është i aksesueshem në të gjithë arkat e njësive administrative të lartepërmenduar si dhe në zyrat e njësive. Numri i madh i operatorëve si dhe numri akoma më i lartë i transaksioneve është shumë e nevojshme mirembajtja e këtij sistemi kaq deciziv për Shoqërinë tonë.*

## **VI. Objekti i shërbimit**

*Objekti i shërbimit është mirembajtja e programit të Faturimit Flare Billing.*

## **VII. Afati i shërbimit**

*-Afati I shërbimit do të jetë 12 muaj nga lidhja e kontratës.*

*-Rezultatet që duhet të arrihen.*

*Mirembajtja e programit të Faturimit Flare Billing që ka në përdorim.*

*Detyrat e Operatorit Ekonomik*

- *Mirembajtja e programit të Faturimit gjatë gjithë periudhës së përcaktuar në kontratë.*
- *Zgjidhje e problemeve teknike prej keqfunksionimit të softëare.*
- *Dorëzim i raportit mujor të mirembajtjes.*

## **VIII. PËRGJIGJJA DHE SHKALLËZIMI I SHËRBIMIT**



Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre.

<b>Kategoria A ( Kritik/ I Larte)</b>	<b>Kategoria B (I Mesem)</b>	<b>Kategoria C (I Ulet)</b>
Mos funksionimi i programit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal	Mos funksionimi i programit krijon vonesa në aktivitetin normal	Mos funksionimi i programit pengon në mënyrë minimal aktivitetin
<b>Numri i përdoruesve të ndikuar</b>		
Mos funksionimi i programit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve	Mos funksionimi i programit ndikon një numër të vogël të përdoruesve	Mos funksionimi i programit ndikon pjesërisht në disa përdorues
<b>Pezullimi i punës</b>		
Mos funksionimi i programit pengon përdoruesit <b><u>të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.</u></b>	Mos funksionimi i programit pengon përdoruesit <b><u>të realizojnë pjesë te punës së tyre</u></b>	Mos funksionimi i programit pengon përdoruesit <b><u>të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre,</u></b>
<b>Zgjidhje alternative e përkohshme</b>		
<b><u>Nuk ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit</u></b>	<b><u>Ka pjesërisht një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.</u></b>	<b><u>Ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.</u></b>
<b>Koha e përgjigjes</b>		
○ 30 min. për të kthyer përgjigje	○ 30 min.për të kthyer përgjigje	○ 30 min.për të kthyer përgjigje
<b>Koha e zgjidhjes</b>		
Maksimumi i pranimi të zgjidhjes është 24 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimi të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.	Maksimumi i pranimi të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

III.4.2. Në shtojcën nr. 8, pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon: **“2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar i zgjidhjes "FLARE BILLING" qe eshte zgjidhja në përdorim. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Ne kete autorizim duhet te perfshihen te dhenat e procedues : Nr i references , Data e procedures,Objekti i procedures, Autoriteti Kontraktor. Ne cdo rast duhet te paraqitet lidhja midis distributorit te autorizuar dhe prodhuesit.”**

III.4.3. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.4.4. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

- “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.*

III.4.5. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
- 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme*

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.4.6. Në nenin 41, pika 2 dhe 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;

d) në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

III.4.7. Nga shqyrtimi i procesverbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në Sistemin e Prokurimit Elektronik konstatohet se autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri si më poshtë:

“**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varesi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Autorizimi i prodhuesit/distributorit të autorizuar,

*eshte nje dokument i rendesishem, pasi pervecse tregon origjinen e suportuesve qe kerkohen ne procedure, na garanton se ofertuesi eshte i autorizuar per ofrimin tek AK te ketyre sherbimeve. Kjo garanci lidhet njekohesisht edhe me treguesit cilesore te sherbimeve qe kerkohen te ofrohen e qe jane krijuar ne standardet apo prodhues te zyrtarizuar. Ky kriter eshte jo diskriminues, eshte ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates dhe lidhet drejtperdrejte me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine e OE ofertues per aftesite teknike. Kjo kerkese i sherben autoritetit kontraktor per njohjen e mundesise se OE-se per permbushje me sukses te kontrates.*

*Duke pasur parasysh dinamiken e punes se stafit te shoqerise, shtrirjen gjeografike te shoqerise, problematikat qe mund te dalin gjate perdorimit te programit te Faturimit kerkohet qe Autoriteti Kontraktor te jete i garantuar qe Operatori Ekonomik ka mbeshtetjen dhe suportin e prodhuesit per te mirembajtur kete program.”.*

III.4.8. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve dhe kushteve për përzgjedhjen e fituesit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për përcaktimin e nevojave të tij për mallra, shërbime e pune, duke përcaktuar për secilën prej tyre sasi të përkatëse dhe të duhura sipas nevojave të tij dhe specifikimet teknike të tyre. Pra, është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, si organi me interes të drejtpërdrejtë për kryerjen e procedurës së prokurimit dhe organi përgjegjës për mirëpërdorimin e fondeve publike, të përcaktojë kriteret kualifikuese që duhet të plotësojnë ofertuesit në përputhje me kriteret dhe zërat e shërbimeve objekt-prokurimi.

Në rastin konkret, Komisioni konstaton se qëllimi i autoritetit kontraktor për prokurimin e kësaj kontrate është Sherbim Mirembajtje e Programit të Faturimit Flare Billing, fakti që autoriteti kontraktor sikurse e ka përcaktuar në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit ka në zotërim një program të markës “Flare Billing” dhe një nga zërat e shërbimit objekt-prokurimi është edhe mirëmbajtja e sistemit që disponon, me përcaktimin e kriterit kualifikues të pikës 2.3.4 të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit kufizon në mënyrë të panevojshme konkurrencën dhe gamën e zgjidhjeve të propozuara, pasi për plotësimin e kësaj pikë ofertuesit duhet që të paraqesin autorizim nga prodhuesi i programit të markës “Flare Billing”, si dhe për më tepër enti prokures nuk ka argumentuar rëndësinë e vendosjes së kësaj kërkesë për kualifikim lidhur me rëndësinë e këtij autorizimi për realizimin e këtij shërbimi, për më tepër përcaktimi i një marke specifike që çon drejt një prodhuesi të vetëm është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit në vendin tonë. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë dokumentat e tenderit duke hequr kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.4 të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit.

**Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qendron.**

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK për heqjen e kriterit 2.3.5 të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “... VII.

Në Shtojcën 8 Formular i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit në pikën 2.3.5 keni kërkuar si më poshtë: 2.3.5 Operatori Ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë një ofertë teknike të detajuar për të gjithë kërkesat e përcaktuara në termat e referencës. Oferta teknike duhet të konsistojë minimalisht në: -përgjigje një më një të kërkesave teknike të specifikuara në termat e referencës. shënim: përgjigje copy-paste të kërkesave nuk do të pranohen (duhen përgjigje të argumentuara për çdo kërkesë të parashikuar në termat e referencës). Ju kujtojmë që në fazën procedurale, atë të dorëzimit të ofertave elektronike, kjo kërkesë përmbushet me anë të shtojcës 9. Formluari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, konkretisht: pjesa iii kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit a: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratësë”.

#### *Deklarata Përgjigje*

*në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga autoriteti kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me listën e mallrave dhe grafikun e lëvizimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Po [ ] Jo [ ] Referuar sa më sipër ne kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë. [...]*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën nr. 8, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

*“2.3.5. Operatori Ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë një ofertë teknike të detajuar për të gjithë kërkesat e përcaktuara në termat e referencës. Oferta teknike duhet të konsistojë minimalisht në:*

*-Përgjigje një më një të kërkesave teknike të specifikuara në Termat e Referencës.*

*Shënim: Përgjigje copy-paste të kërkesave nuk do të pranohen (duhen përgjigje të argumentuara për çdo kërkesë të parashikuar në Termat e Referencës). ”.*

III.5.2. Nga shqyrtimi i procesverbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteve për kualifikim” të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në Sistemin Elektronik të Prokurimit konstatohet se autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues duke u shprehur si në vijim: “**Argumentimi:** Kjo kërkesë vendoset në mbështetje të nenit 41, pika 4 ç) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Ne përgjigje të kërkesave të termave të referencës, kërkohet që Ofertuesi të paraqesë zgjidhjen e tij për secilën kërkesë. Këto zgjidhje kërkohet të percaktohen në formën e përgjigjes për çdo pikë/kërkesë të ToR. Përgjigjet duhet të argumentohen në zgjidhjen specifike të ofertuar.

*Ky kriter është vendosur për të garantuar aftësinë e Operatorit Ekonomik për të realizuar në kohe dhe me cilësi implementimin e zgjidhjes së ofruar dhe realizimin e të gjitha kërkesave të tjera të përcaktuara në Specifikimet Teknike dhe Termat e Referencës. Nepermjet ofertes Teknike AK do të kuptojë shumë me qartë që OE i ka kuptuar kërkesat dhe funksionalitetet e përcaktuara në Termat e Referencës dhe në këtë mënyrë kuptohet dhe mënyra se si do të*

*realizohen detyrat e percaktuara.*”, duke mos argumentuar teknikisht dhe nga ana funksionale vendosjen e këtij kriteri kualifikues.

III.5.3. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “*Primus Albania*” ShPK autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes me anë të shkresës nr. 3900 prot., datë 18.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2494/3 prot., datë 23.10.2023 drejtuar ankimuesit ka argumentuar si në vijim: “*Siç mund të shikohet qartësisht kjo kërkesë është e parashikuar në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik. Kërkesa për paraqitje ofertë teknike lidhet ngushtësisht me të drejtën e AK për të vendosur kriteret të cilat i mendon të arsyeshme për mbarëvajtjen e punës dhe kryerjen e shërbimeve objekt kontrate në mbështetje afateve dhe kushteve të parashikuara në specifikimet teknike. Oferta teknike është shumë e rëndësishme sepse në këtë mënyrë OE dëshmon se si do ta realizojë detyrat object-kontrate dhe në këtë mënyrë AK kupton kapacitetet e OE. Me vendosjen e këtij kriter nuk ka asgjë diskriminuese. Duket e habitshme që kundërshtoni një pikë të tillë. Mbi të gjitha argumentimi i kryer në shtojcën përkatëse është shterues, i plotë dhe nuk gjendet arsye për ta kundërshtuar. Për sa më sipër cituam pretendimi i OE Primus Albania për pikën VII nuk qëndron.*”, duke mos e pranuar këto pretendime të ankimuesit.

III.5.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e percaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.5.5. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.”*

III.5.6. Në nenin 77, pikat 1, 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se::

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.5.7. Në nenin 41, pikat 2, 4 dhe 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

*4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

III.5.8. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve dhe kushteve për përzgjedhjen e fituesit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për përcaktimin e nevojave të tij për mallra, shërbime e pune, duke përcaktuar për secilën prej tyre sasi të përkatëse dhe të duhura sipas nevojave të tij dhe specifikimet teknike të tyre. Pra, është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, si organi me interes të drejtpërdrejtë për kryerjen e procedurës së prokurimit dhe organi përgjegjës për mirëpërdorimin e fondeve publike, të përcaktojë kriteret kualifikuese që duhet të plotësojnë ofertuesit në përputhje me kriteret dhe zërat e shërbimeve objekt-prokurimi.

Në rastin konkret, Komisioni konstaton së referuar procesverbalit të argumentimit të kriterëve i publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor nuk është argumentuar jo vetëm ligjërisht por edhe nga ana funksionale rëndësia e vendosjes së këtij kriteri për arritjen e qëllimit për të cilin po kryhet ky prokurim nga ana e autoritetit kontraktor. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë dokumentat e tenderit duke hequr kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.7 të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qendron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të



*Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Proçedurë e Hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-82854-10-09-2023, me objekt “*Sherbim Mirembajtje e Programit te Faturimit Flare Billing per 12 muaj*” me fond limit 6.000.000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster SH.A.
  2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Proçedurë e Hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-82854-10-09-2023, me objekt “*Sherbim Mirembajtje e Programit te Faturimit Flare Billing per 12 muaj*” me fond limit 6.000.000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster SH.A.
  3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
  4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK.
  6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
  7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

